

Debat publik në Resnje

Më 21 mars të vitit 2008 në Resnje u mbajt debat publik në temë “Mbrojtja e të drejtave të bashkësive etnike jo shumicë në Resnje dhe Manastir”, qëllimi i të cilit ishte të iniciohet diskutimi mes përfaqësuesve të pushtetit lokal dhe atij qendror, organizatave joqeveritare dhe qytetarëve për shkak të theksimit të nevojës për mbrojtje të drejtave dhe nevojave të bashkësive etnike jo shumicë në Resnjë dhe Manastir. Në debatin publik morën pjesë 22 përfaqësues nga organizatat joqeveritare, 19 përfaqësues nga institucionet, 2 këshilltarë nga Këshilli i komunës së Resnjes dhe 2 gazetarë.

Fjalime hyrëse mbajtën Zëvendës Ministri i Drejtësisë Sasko Vasilevski dhe Zëvendës Avokati i Popullit – zyra rajonale në Manastir, Liljana Ilievska. Sasko Vasilevski foli për gjendjen e bashkësive etnike jo shumicë në vend, për amendamentet e aprovuara dhe ndryshimet në Kushtetutën e R. Maqedonisë, për rregulloren ligjore me të cilën garantohet mbrojtja e të drejtave të bashkësive etnike jo shumicë dhe për implementimin e Marrëveshjes Kornizë. Liljana Ilievska e sqaroi rolin e Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të drejtave të bashkësive etnike jo shumicë dhe mënyrën e dorëzimit të ankesave deri te Avokati i Popullit gjatë thyerjes së të drejtave të tyre.

Në vazhdim të debatit para të pranishmëve u drejtuan përfaqësues të sektorit joqeveritar. Për gjendjen e popullatës romë në Manastir dhe për rastet e diskriminimit të romëve foli Erxhan Kasum, anëtarë i OJQ “Sonce” nga Manastiri. Arsimi, masat për tolerancë, përfaqësimi i drejtë dhe gjendja e bashkësisë etnike turke në Resnje ishin pikat themelore për të cilat foli Xhemal Mehmed, kryetar i ZOKUS “Nijazi Bej” nga Resnja. Omer Sulejman nga Qendra për Zhvillim të Shoqërisë Civile “Via Vita” nga Manastiri foli për mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të bashkësive etnike jo shumicë.

Gjatë diskutimit shumë pjesëmarrës e theksuan problemin me përfaqësimin e pamjaftueshëm të bashkësive etnike jo shumicë në institucionet shtetërore dhe problemet në arsim, kurse aksent iu dha edhe diskriminimit aktual të bashkësive etnike, punësimit dhe zgjidhjeve ligjore gjegjësisht procedurave për dorëzimin e ankesave te Avokati i Popullit.

Nga debati doli konkludimi se ekzistojnë probleme dhe nevoja për mbrojtjen e të drejtave të bashkësive etnike jo shumicë në Resnje dhe Manastir edhe atë: diskriminimi, masa për tolerancë, arsim/gjuhë dhe përfaqësim i drejtë i bashkësive etnike në administratën publike. Të pranishmit u njoftuan me deri tani procedurat e panjohura për dorëzimin e ankesave deri te Avokati i Popullit, kurse qytetarët u inkurajuan nga ana e Zëvendës Avokatit të Popullit që të bëjnë ankesa për raste konkrete të diskriminimit. Në fund u theksua nevoja për komunikim të vazhdueshëm të gjithë institucioneve, organeve, organizatave dhe subjekteve që punojnë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e të drejtave të bashkësive etnike jo shumicë.

Debati u organizua nga Fondacioni Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me zyrën lokale të projektit në Resnje (Qendra për përkrahje të bashkësive Resnjë, ish Qendra për përkrahjen e OJQ-ve). Moderator i debatit publik ishte Roze Janevska nga Qendra për zhvillim lokal “Antigonea” nga Negotina.